



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 733/7 prot.

Tiranë, më 30.05.2025

REKOMANDIM

Nr. 24, datë 30.05.2025

PËR KONTROLLUESIN

“DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”¹ (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës” (në vijim, “Kontrolluesi ose DPSHP”), “Dega Territoriale e Shërbimit të Provës, Elbasan” (në vijim, “D.T.SH.P. Elbasan”), “Dega Territoriale e Shërbimit të Provës, Vlorë” (në vijim, “D.T.SH.P. Vlorë”), “Dega Territoriale e Shërbimit të Provës, Korçë” (në vijim, “D.T.SH.P. Korçë”) dhe “Dega Territoriale e Shërbimit të Provës, Shkodër” (në vijim, “D.T.SH.P. Shkodër”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 32, datë 20.02.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Shërbimit të Provës, vëren se:

¹Ligji aktual në fuqi, i cili shfuqizon ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Për këtë arsye, orientojmë të gjithë subjektet e ligjit, të përditësojnë bazën ligjore në të gjitha aktet rregullatore.

1. Shërbimi i Provës është person juridik publik, që ushtron veprimtarinë e tij në varësi të Ministrit të Drejtësisë. Shërbimi i Provës organizohet në nivel qendror nëpërmjet DPSHP dhe në nivel vendor nëpërmjet degëve territoriale të tij.

DPSHP ka në objekt të veprimtarisë, zbatimin e vendimeve gjyqësore penale dhe urdhërimeve të prokurorit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative jo me burgim dhe trajtimin e individualizuar të nevojave dhe aftësive të personit nën mbikëqyrje për të siguruar përshtatjen dhe riintegrimin e tij në shoqëri. Gjithashtu, DPSHP është struktura përgjegjëse për organizimin, drejtimin dhe koordinimin e procesit të mbikëqyrjes elektronike, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Grupi i hetimit administrativ, ka analizuar fushën e veprimtarisë dhe dokumentacionin provues të vendosur në dispozicion, duke identifikuar detyrimet dhe përgjegjësitë e strukturave dhe punonjësve të përfshirë në këtë proces, prej të cilave rezulton se, Shërbimi i Provës strukturohet në nivel qendror nga DPSHP, i cili përpunon informacion statistikor dhe degët territoriale, të cilat administrojnë dosjet personale dhe popullojnë sistemin e personave nën mbikëqyrje.

Në këto kushte, me qëllim kryerjen e një hetimi administrativ të saktë dhe gjithëpërfshirës pranë Shërbimit të Provës, në nivel qendror dhe vendor, si dhe për evidentimin sa më të plotë të situatës lidhur me përpunimin e të dhënave personale e sensitive gjatë ushtrimit të veprimtarisë, grupi i hetimit administrativ, mbështetur në pikën 1/h, të nenit 82 të Ligjit dhe në objektin e hetimit të Urdhrit nr. 32, datë 20.02.2025 të Komisionerit, e ka shtrirë hetimin administrativ në Degët Territoriale të Shërbimit të Provës, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Shkodër.

2. Rezulton se, Kontrolluesi, bazuar në ligjin nr. 78/2020 *“Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës”*, i ndryshuar, legjitimohet të përpunojë të dhëna personale për kategoritë, *“punonjës”* dhe *“persona nën mbikëqyrje”*.

Kontrolluesi, në funksion të veprimtarisë së tij, përpunon të dhëna personale, sipas kategorive: *“Emër”*, *“Atësia”*, *“Amësi”*, *“Mbiemër”*, *“Data e lindjes”*, *“Nr. i identifikimit”*, *“Gjinia”*, *“Vendlindja”*, *“Shtetësia”*, *“Angazhimi profesional”*, si dhe të dhëna sensitive, të tilla si: *“Grupi i gjakut”*, *“Gjendja penale”*. Përpunimi i këtyre të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

3. DPSHP ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, rregulloren e brendshme, të vitit 2024. Kjo rregullore është e detyrueshme për t’u zbatuar nga Kontrolluesi dhe degët territoriale të tij.

Nga analizimi i aktit të mësipërm, rezulton se, në këtë rregullore nuk parashikohet asnjë dispozitë lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale gjatë ushtrimit të veprimtarisë, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së*

të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Gjithashtu, rezulton se, Kontrolluesi nuk disponon rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi përcaktimin e kategorive të të dhënave personale, mënyrën e përpunimit të tyre nga DPSHP dhe degët territoriale, nivelet dhe rolet e aksesit të punonjësve, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e ruajtjes së të dhënave personale, të drejtat e subjekteve, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një rregulloreje “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën duhet të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, nivelet dhe rolet e aksesit të tyre në të dhëna personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 28 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

4. Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, në cilësinë e provës, rregulloren “Për administrimin dhe përcaktimin e roleve që kanë të drejta aksesit në bazën e të dhënave të personave nën mbikëqyrje në Sistemin e Shërbimit të Provës”, miratuar me Urdhër nr. 27, datë 18.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Në zbatim të nenit 3 të Urdhrit të mësipërm, parashikohet se DPSHP, është institucioni administrues i sistemit dhe i bazës së të dhënave të personave nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës, që ka të drejta të plota mbi administrimin dhe ndërveprimin si për të dhënat parësore, për të dhënat dytësore dhe proceset elektronike të punës.

Gjithashtu, referuar rregullores së brendshme, konkretisht, seksionit II (nenet 8,9, dhe 10) ku parashikohen detyrat e Drejtorisë së Mbikëqyrjes Elektronike, si dhe nenit 36 “Rregullat e përdorimit të rrjetit dhe pajisjeve elektronike” të saj, përcaktohet se, Kontrolluesi aplikon rrjete elektronike me qëllim kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në rregullore.

Gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, si dhe nga deklaratat e përfaqësuesve të DPSHP dhe D.T.SH.P. Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Shkodër, të përcjella nëpërmjet postës elektronike, deklarohet se ky sistem nuk është funksional, e për rrjedhojë, nuk kryhet asnjë proces përpunues me të dhëna personale.

Lidhur me deklaratimet e mësipërme, grupi i hetimit administrativ ka kryer verifikimet në terren, si dhe ka konstatuar se, D.T.SH.P. Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Shkodër, administrojnë dokumentacionin përkatës në lidhje me personat nën mbikëqyrje, në

format elektronik “*excel*”, sipas një modeli standard me rubrikat përkatëse, të miratuar me Urdhrin nr. 72, datë 24.05.2024 të DPSHP.

Për sa më sipër, rezulton se, në rregulloren e brendshme dhe aktet e tjera, të cilat ngarkojnë me detyrime ligjore për zbatim, DPSHP dhe degët territoriale të saj, parashikohen rregulla të pa aplikueshme, lidhur me programet dhe sistemet elektronike që përdoren gjatë veprimtarisë së Shërbimit të Provës.

Grupi i hetimit administrativ konstaton se DPSHP dhe D.T.SH.P. Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Shkodër nuk kanë zbatuar detyrimet e parashikuara për funksionimin e bazës së të dhënave, me qëllim administrimin elektronik të dokumentacionit bazë të të gjitha dosjeve të personave nën mbikëqyrje, si dhe për të rivendosur disponueshmërinë dhe aksesin në të dhënat personale brenda një kohe të arsyeshme në rast incidenti fizik ose teknik, në kundërshtim me parashikimet e germave “b”, “c”, “ç”, të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 28 të Ligjit, si dhe germat “g” dhe “f” të pikës 2, të nenit 66 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi, në “*Rregulloren e brendshme të Shërbimit të Provës*”, parashikon rregulla të përgjithshme dhe jo të aplikueshme, lidhur me proceset përpunuese që kryen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, duke mos parashikuar në të, rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën dhe nivelet e aksesit në të dhënat personale, në përputhje me detyrat funksionale të çdo punonjësi, referuar pozicionit të punës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 dhe 66 të Ligjit.

Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, duke përditësuar mënyrën e administrimit elektronik të dokumentacionit që përmban të dhëna personale e sensitive, në mënyrë që të garantohet siguria e përpunimit, sipas përcaktimeve të nenit 66 të Ligjit, si dhe të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë së të dhënave, nivelet e aksesit në të dhënat personale sipas proceseve përpunuese (konkretisht në nenet 8,9,10 dhe 36 të rregullores së brendshme, ku përshkruhen procese përpunimi të të dhënave, të cilat nuk gjejnë zbatim konkret lidhur me veprimtarinë që ushtron Kontrolluesi), në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 dhe 66 të Ligjit.

5. Rezulton se, DPSHP ka të instaluar sistemin e video survejimit CCTV, përmes së cilit kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme ku ushtron veprimtarinë e tij, për qëllim të mbrojtjes së pronës dhe sigurisë së kontrollit mbi hyrjet dhe daljet.

Nga verifikimet e kryera në terren, rezulton se, në sistemin e video survejimit CCTV, kanë akses edhe punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilët, në mënyrë grafike, caktohen të qëndrojnë në hyrje të DPSHP, me qëllim monitorimin e lëvizjeve në institucion, për arsye sigurie.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se, lidhur me këtë proces përpunues, DPSHP nuk ka miratuar rregulla apo politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, etj., nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Nga verifikimet e kryera në terren, konstatohet se, në ambientet e DPSHP, nuk janë vendosur tabela njoftuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV, me elementët informues sipas modelit standard të miratuar, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave dhe të drejtat që ata gëzojnë, lidhur me përpunimin e të dhënave imazhe/video nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 dhe 55 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 30.04.2025 të Komisionerit *“Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e videosurvejimit”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 3”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video survejimit CCTV. Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “imazhe”, “video” janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale me anë të sistemit CCTV, nga ana e Kontrolluesit, duhet të dokumentohet me një akt të brendshëm, lloji, specifikimet e kamerave, vendosja e tyre në përputhje me qëllimin për të cilin do të përdoren, si dhe përcaktimi i saktë i zonave që do të jenë nën mbikëqyrje, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 2 të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Për më tepër, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV, është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbyllja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

6. Nga hetimi administrativ i ushtruar në terren, rezulton se D.T.SH.P. Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Shkodër nuk kanë marrë masa lidhur me sigurinë e ambienteve fizike, si dhe masa teknike e organizative, për të garantuar sigurinë e përpunimit të të dhënave personale që administrojnë gjatë veprimtarisë, nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, në kundërshtim me nenin 28 e 66 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Për rrjedhojë, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi dhe degët territoriale të tij, duhet të marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të garantuar

mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në përputhje me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, niveli i sigurisë së ambienteve fizike duhet të jetë i përshtatur me natyrën e përpunimit dhe kategoritë e të dhënave personale dhe sensitive, të cilat përpunohen nga DPSHP.

7. DPSHP ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, kontratë shërbimi, nënshkruar nga Agjencia Kombëtare e Shqipërisë së Informacionit me shoqërinë “Fastech” sh.p.k., me objekt: *“Mirëmbajtje e sistemit të Shërbimit të Provës”*, me përfitues DPSHP.

Nga shqyrtimi i kontratës së mësipërme dhe kushteve të veçanta të kontratës, bashkëlidhur saj, rezulton se, në to, nuk janë reflektuar rolet, detyrimet dhe përgjegjësitë mes kontrolluesit dhe përpunuesit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”*, i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, duhet të jenë të përfshira në kontratën ose aneks kontratën e hartuar dhe nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi, që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marrë përpunuesi për të siguruar e garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

8. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se, DPSHP nuk ka marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 33, 34 dhe 68 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, caktimi i një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim i rëndësishëm që ka për qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese që realizohen nga ana e Kontrolluesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit në rastin e caktimit të një nëpunësi të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas këtij Ligji.

9. Gjithashtu, rezulton se, DPSHP dhe degët territoriale të saj, nuk kanë marrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në Kreun IV, të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës së Shërbimit të Provës dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, si dhe i është lënë afat të depozitojë pretendimet me shkrim, referuar procesverbalit të hartuar nga ana e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 21.05.2025, kanë shprehur dakordësinë lidhur me konstatimet e grupit të hetimit dhe kanë deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e hetimit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara.

Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi lidhen me përpunimin e ligjshëm të të dhënave, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjes së masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 13, 26, 28, 33, 34, 55, 66, 68, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të hartojë rregulloren "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", duke parashikuar në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që

përpunohen, mënyrën e përpunimit të tyre nga DPSHP dhe degët territoriale, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e roleve dhe niveleve të aksesit në të dhëna, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave personale, në përputhje me proceset përpunuese të Shërbimit të Provës;

2. Kontrolluesi, të marrë masa për rishikimin e rregullores së brendshme, duke përditësuar mënyrën e administrimit elektronik të dokumentacionit që përmban të dhëna personale e sensitive, në mënyrë që të garantohet siguria e përpunimit, si dhe të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën elektronike të përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë së të dhënave, nivelet e aksesit në të dhënat personale sipas proceseve përpunuese (konkretisht në nenet 8, 9, 10 dhe 36 të rregullores së brendshme, ku përshkruhen procese përpunimi të të dhënave, të cilat nuk gjejnë zbatim konkret lidhur me veprimtarinë që ushtron Kontrolluesi), sipas parashikimeve të nenit 28 dhe 66 të Ligjit;
3. Kontrolluesi të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullave apo politikave, për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, lloji dhe specifikimet e kamerave, vendosja e tyre në përputhje me qëllimin për të cilin do të përdoren, si dhe përcaktimin e saktë të zonave që do të jenë nën mbikëqyrje etj., sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3 dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për vendosjen e tabelave informuese në ambientet e survejuara përmes sistemit CCTV, sipas modelit standard të miratuar në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 dhe 55 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi, të përfshijë në kontratë dhe/ose aneks kontratë, të nënshkuar mes kontrolluesit dhe përpunuesit, detyrimet për përcaktimin e rregullave specifike në lidhje me marrëdhënien mes palëve, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit;
6. Kontrolluesi të marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të neneve 33, 34 dhe 68 të Ligjit, si dhe të njoftojë Zyrën e Komisionerit për caktimin e tij;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre;
8. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:

- (i) menjëherë, detyrimin e treguar në pikën 6 më sipër;
- (ii) vazhdimisht, detyrimin e treguar në pikën 7 më sipër;
- (iii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 4 dhe 5 më sipër;
- (iv) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 3 më sipër;
- (iv) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1 dhe 2 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;

10. Në rast mospërbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri, bazuar në germën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast shkeljesh serioze ose të qëllimshme të dispozitave ligjore, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 30.05.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi